

PKR.nr.758/15

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA** si gjykatë e shkallës së parë penale, kryetarja e trupit gjykues, gjyqtarja Suzana Çerkini me sekretaren juridike Ardita Azemi, në çështjen penale kundër të pandehurit Q.M. nga fshati Sh. Komuna L., për shkak të veprës penale Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par.1 te KPRK, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PP.L.nr.687/14 të datës 28.12.2015, pas shqyrtimit fillestar, të hapur për publikun, të mbajtur më datë 15.12.2016 në praninë e Prokurorit të shtetit, Kujtim Munishi, të pandehurit Q.M., me mbrojtësin me autorizim av.J.B., të njëjtën ditë, mori dhe shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri Q.M.**, i biri i D. dhe nënës F., e vajzërisë J., i lindur me *data e lindjes...*, në fshatin Sh. Komuna L., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën e mesme, i punësuar si administrator ne shkollën fillore “I. B.”, fshati Sh., i martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me letërnjoftim RKS me nr. *personal numër personal...*,

**Ë S H T Ë F A J T O R**

**Sepse**, me datë 15.06.2014, rreth orës 14:00, ne fshatin Sh. KK L., ka përdorë armën-pushkën e gjuetisë te tipit “Çifsan” me numër serik 15301 për të cilën ka poseduar leje valide, ashtu që: për të eliminuar një qen endacak i cili me parë iu kishte shkaktuar dëme, ka shkuar deri tek fundi i një are pranë shtëpisë së tij dhe ka shtënë në drejtim të qenit me ç’rast tre nga predhat e pushkës godasin xhamin e dritares, kornizën e dritares dhe xhamin e derës hyrëse te korridorit te shtëpisë se fqinjtit te tij,

- me këtë ka kryer veprën penale, Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 te KPRK,

Andaj gjykata, në bazë të neneve 7, 17, 41,42, 46, 62 par.2.6, 69, 73, 74 të KPRK dhe neneve 233, 248, 365, 366 të KPP, i shqipton,

## **DËNIM ME GJOBË**

Në shumen prej **450 euro**, te cilin dënim, obligohet që ta paguaj brenda afatit prej 15 ditësh por jo me gjatë se tre muaj pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

Nëse i pandehuri nuk e paguan gjobën e shqiptuar, gjykata do t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgimi llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë,

I pandehuri obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej **50 euro (pesëdhjetë)** brenda afatit prej 15 ditësh, por jo më gjatë se tre muaj, pasi ky aktgjykim të merr formën e prerë,

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda me aktakuzën PP.I.nr.687/14, të datës 28.12.2015, ka akuzuar Q. M., për veprën penale Përdorimi i armës apo mjetit te rrezikshëm nga neni 375 par. 1 të KPRK, dhe njëherësh i ka propozuar gjykatës që pas administrimit të provave në shqyrtim gjyqësor, të pandehurin t'a shpall fajtor, dhe t'a dënojë sipas ligjit.

Prokuroria Themelore në Prishtinë, Departamenti për Krime të Rënda, së bashku me Aktakuzë, të njëjtën ditë i ka parshtruar gjykatës edhe Marrëveshjen me shkrim për Pranim të Fajësisë, të arritur me të pandehurin Q. M. me datë 24.11.2016.

Gjykata, duke vepruar në këtë çështje penale sipas aktakuzës së lartshënuar, mbajti seancë të shqyrtimit fillestar me datë 15.12.2016, në të cilën prokurori i shtetit theksoi se me të pandehurin Q. M., me datë 24.11.2016 kishte arritur Marrëveshje për pranim të fajësisë, dhe vazhdon të mbetet pranë të njëjtës marrëveshje, si dhe i ka propozuar që dënimi plotësues të mos aplikohet nga gjykata me vetë faktin se armën të cilën i pandehuri e ka përdorur, ka qenë armë me leje dhe gjatë negociimit të marrëveshjes prokuroria është interesuar për të kaluarën kriminale të të pandehurit, që rezulton se i njëjti nuk ka asnjë vepër penale më herët dhe që predispozohet se edhe në të ardhmen nuk do të kryej vepër penale. Gjithashtu marrëveshjen e mbështeti edhe i pandehuri pa vërejtje dhe mbrojtësi i tij, av. J.B., i cili kërkoi nga gjykata se me rastin e vendosjes te këtë parasysh mënyrën dhe kohën e kryerjes së veprës penale si dhe pasojat të cilat nuk ekzistojnë fare, sinqeritetin e të mbrojturit të tij, si dhe gjendjen e ekonomike të tij, ashtu qe dënimi te jetë më i arsyeshëm.

Andaj, gjykata pas konfirmimit se janë përmbushur kushtet e parapara në dispozitën ligjore nga neni 233 të KPP, pa asnjë vërejtje nga palët, me aktvendim, ka aprovuar në tërësi marrëveshjen për pranim fajësie nga i pandehuri Q.M. dhe, ka urdhëruar që e njëjta të vendoset në shkresa të

lëndës. Pas aprovimit të kësaj marrëveshjeje si dhe pas vlerësimit të rrethanave të rastit, gjykata konstatoi gjendjen e fakteve që e përmban akuza, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm, se në veprimet e të pandehurit, ekzistojnë elementet e veprës penale të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që më parë gjeti se i pandehuri është penalisht përgjegjës, të njëjtin e shpalli fajtor për veprën penale që i vihet në barrë, dhe i shqiptoi dënim të paraparë ligjor.

Me rastin e përcaktimit të vendimit mbi dënimin ndaj të pandehurit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara ligjore që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, si, rrethanat lehtësuese, marrëveshjen për pranimin e fajësisë bashkë me dënimin e rekomanduar, paraqitjen korrekte në gjykatë, pendimin për veprën e kryer, premtimin se nuk do të përsërisë vepra të tilla, gjendjen ekonomiko-materiale të të njëjtit, ndërsa rrethanë rënduese nuk gjeti, andaj të pandehurit i shqiptoi dënim me gjobë të precizuar si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se dënimi i tillë i përgjigjet peshës së veprës penale, sjelljeve dhe shkallës së përgjegjësisë penale të pandehurit dhe, se ky dënim do të ndikojë në risocializimin e të njëjtit, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, gjithashtu, do të ndikojë tek të tjerët në mos kryerjen e veprave penale dhe se, me dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK dhe në fund, me bindje se i pandehuri në të ardhmen nuk do të përsërisë veprë tjetër penale të natyrës së tillë apo të ngjashme.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor, gjykata e mori në bazë të nenit 450 par.2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP.

Nga sa u tha më lartë, dhe në bazë të nenit 365 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA  
PKR.nr.758/15, me datë 15.12.2016**

**Sekretarja juridike  
Ardita Azemi**

---

**Kryetarja e trupit gjykues-gjyqtarja,  
Suzana Çerkini**

---

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Ankesa bëhet përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.